

Të nderuar të pranishëm,

Kam kënaqësinë dhe nderin e veçant të hapë punimet e kësaj konference dhe të ju dëshiroj mirëseardhje të gjithë pjesëmarrësve. E veçanta e kësaj konference është se për herë të parë po bëjmë një organizim të tillë në bashkëpunim me Bankën Kombëtare të Austrisë dhe me Bankën Investive Evropiane, institucione këto që në vazhdimësi i kanë kushtuar vëmendje shumë të madhe analizave dhe hulumtimeve mbi zhvillimet ekonomike dhe financiare në rajonin tonë. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, ne kemi arritur që sot në Prishtinë të kemi një grup folësish shumë të shquar që vijnë nga institucione shumë të rëndësishme ndërkombëtare dhe vendore, të cilët na kanë nderuar me ardhjen e tyre në këtë konferencë.

Konferenca e sotme ka të bëjë me Qasjen në Financa, Kreditimin Bankar dhe Sektorët Bankarë në vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore, ku pritet të kemi diskutime interesante prej pikëvështrimeve të ndryshme mbi zhvillimet në sektorët bankarë të këtij rajoni dhe mbi rolin e tyre në ekonominë e këtyre vendeve. Zhvillimet para krizës së fundit dhe ato gjatë dhe pas krizës na kanë rikujtuar se sektori bankar paraqet një shtyllë shumë të rëndësishme të zhvillimit ekonomik, por po ashtu, kur gjërat nuk ecin mirë, mund të paraqesë edhe një burim shumë të rëndësishëm të problemeve për ekonominë e një vendi. Prandaj, konferencat si kjo paraqesin një mundësi shumë të mirë për të parë se nga po ecin sektorët bankarë të rajonit tonë dhe si po zhvillohet lidhja ndërmjet tyre dhe ekonomive ku po veprojnë.

Para fillimit të krizës globale, sektorët bankarë të rajonit karakterizoheshin me një rritje të shpejtë të kreditimit, por efektet e krizës bënë që kreditimi në këto vende të zvogëlohej ose të ngadalësonte ritmin e rritjes, gjë e cila nuk kaloi pa pasoja për aktivitetin e përgjithshëm ekonomik në këto vende. Megjithatë, duket se në vitet e fundit po ndodhë një rikuperim i afarizmit bankar dhe kreditimi bankar po shënon përshpejtim të ritmit të rritjes në shumicën e këtyre vendeve. Përmirësimi i cilësisë së portofolit kreditor konsiderohet si një faktor me kontribut të rëndësishëm në nxitjen e kreditimit bankar, mirëpo fakti se norma e kredive joperformuese në shumicën e këtyre vendeve mbetet mbi nivelin e para-krizës nënkupton se problemet me cilësinë e kredive mund të jenë duke parandaluar një rritje edhe më të shpejtë të kreditimit. Prandaj, qështja e kredive joperformuese vijon të jetë një temë e rëndësishme së veçantë si kur diskutojnë për stabilitetin financiar, ashtu edhe kur diskutojnë për rolin e bankave në mbështetjen e zhvillimit ekonomik në vendet ku operojnë. Kjo qështje konsideroj se do të zë një vend të rëndësishëm edhe në diskutimet e sotme, përmes së cilave do të kemi rastin të ndëgjojmë më tepër rreth problemeve të kthimit të kredive dhe mënyrave të zgjidhjes së tyre.

Vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore janë dëshmuar të jenë mikpritës të mirë të bankave të huaja. Sot bankat e huaja zotërojnë pjesën më të madhe të tregut në këto vende dhe kanë arritur të performojnë më mirë se sa bankat që operojnë në Evropën Perëndimore. Në kthim të kësaj, bankat e huaja i kanë kontribuar shumë zhvillimit të sektorëve bankarë të vendeve tona, duke i sjellur praktikat moderne të bankingut, si dhe duke mundësuar një rritje më të shpejtë të kreditimit në saje të transfereve ndërkufitare. Sidoqoftë, zhvillimet e pas-krizës kanë ngritur disa pyetje lidhur me gatishmërinë e këtyre bankave për të rritur ekspozimin e tyre në vendet e rajonit. Në këtë kontekst, kjo konferencë ofron një platformë të mirë për diskutimin e të ardhmes së sektorëve bankarë të rajonit tonë, me theks të veçant mbi zhvillimet e pritura të kreditimit dhe qasjes në financa.

Sektori bankar i Kosovës, i përbërë nga tetë banka me pronësi të huaj dhe dy vendore, vazhdon të karakterizohet me zhvillime shumë të favorshme si për nga roli i tij si ndërmjetësues financiar, ashtu edhe për nga shkalla e qëndrueshmërisë. Në vitet e fundit, qasja në financa në Kosovë ka shënuar përmirësim të theksuar, marrë parasysh përshpejtimin e trendit të kreditimit dhe rënien e theksuar të normave të interesit. Avancimi i qasjes në financa në Kosovë tregohet edhe nga raporti i fundit i Bankës Botërore mbi Lehtësinë e të Bërit Biznes, ku Kosova është radhitur në vendin e 12-të, nga gjithsej 190 vende të përfshira në këtë raport. Sektori bankar i Kosovës vazhdon të dallohet edhe për nga treguesit e shëndetit financiar, ku dëshiroj të theksoj normën e ulët të kredive joperformuese, e cila aktualisht po qëndron në 3.6 përqind.

Këto dhe qështje të tjera të rëndësishme lidhur me zhvillimet në sektorët bankarë të rajonit tonë do të diskutohen në kuadër të paneleve diskutuese, përbërjen dhe radhitjen e të cilave mund t'i shihni në agjendën e konferencës.

Në përfundim të fjalës sime, më lejoni të shpreh mirënjohjen e veçantë për Bankën Kombëtare të Austrisë dhe Bankën Investive Evropiane për bashkëpunimin e shkëlqyer në organizimin e kësaj konference. Po ashtu, dëshiroj t'i falënderoj të gjithë pjesëmarrësit e kësaj konference dhe në veçanti ata të cilët kanë udhëtuar për të qenë sot këtu me ne. Shpresoj se temat që do të diskutohen sot do të jenë interesante për ju dhe ju dëshiroj diskutime të frytshme.

Juve që keni ardhur nga jashtë ju dëshiroj një qëndrim shumë të këndshëm në Kosovë dhe shpresoj se do të keni rastin që, përveç ndjekjes së konferencës, të njiheni pak më gjerësisht me Prishtinën dhe Kosovën.

Ju faleminderit!

